

TAKIMI I TRETË 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **21.12.2023**.

Meqë ishte takimi i fundit për vitin 2023, mbledhja u hap me evidentimin se cilësia e kurrikulave dhe e shkollave bënte të mundur që të kishte nxënës të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës. Nga AKAFPK u theksua se, përgjegjësia ishte elementi kyç për çdo iniciativë që ndërmerrej dhe çdo dokument që prodhohej. Gjithashtu, u theksua se, Komiteti funksiononte falë motivimit të anëtarëve për të kontribuar dhe se në të kundërt ky mekanizëm nuk do të mund të ekzistonte. Ky fakt e bënte Agjencinë të ishte shumë e kujdesshme në cilësinë e dokumenteve që hartonte.

Validimi i standardit të profesionit “*Specialist i sigurisë kibernetike*”

Në vijim të pikave të agjendës u mor në shqyrtim për validim standardi i profesionit “*Specialist i Sigurisë Kibernetike*”. Përfaqësuesi i grupit hartues të standardit të profesionit shpjegoi vizionin mbi të cilin grupi kishte punuar gjatë përgatitjes së dokumentit.

Më pas Sekretariati prezantoi funksionet dhe detyrat e standardit të profesionit “Specialist i Sigurisë Kibernetike”. Anëtarët e Komitetit e shqyrtuan dokumentin rubrikë pas rubrike dhe diskutuan mbi çdo paqartësi apo formulim.

Në përfundim, dokumenti i hartuar pësoi ndryshime shumë të vogla dhe anëtarët vlerësuan punën e bërë nga grupi hartues.

Në mbyllje të takimit u falënderuan anëtarët e grupit hartues për kontributin e dhënë gjatë hartimit të dokumentit dhe gjatë takimit për të qartësuar anëtarët e Komitetit Sektorial mbi përmbajtjen e standardit.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U validua pa ndryshime standardi i profesionit: “*Specialist i sigurisë kibernetike*”.